

## **EMERLINDA (GURI) PEMA**

Prej muajit mars 2024 mban rolin e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës, në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Më parë (2022-2023) ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve. Është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Juridike, gjithashtu është diplomuar në Fakultetin e Shkencave me profil studimor Marrëdhënie dhe Ekonomi Ndërkombëtare, si dhe ka kryer Master pas-universitar për Integrimin European, në Universitetin e Padova-s, Itali. Ka një eksperiencë të pasur profesionale, fillimisht si nëpunëse civile/juriste pranë Ministrisë së Shëndetësisë, si lektore e jashtme pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin Evropian të Tiranës dhe juriste e jashtme e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka qenë pjesë e skuadrës së Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) me qendër në Vjenë, edhe gjatë Kryesisë Shqiptare të OSBE-së në vitin 2020, duke mbuluar kryesisht aktivitetin administrativ. Zotëron gjuhën italiane dhe angleze, si dhe ka njohuri të gjuhës spanjolle.